



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:286274

Datë: 09.11.2024

Numri i dokumentit: 06429848

C.nr.719/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri, me bashkëpunëtorin profesional Senad Telaku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.H. nga fshati B.-Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson av. Asman Hoxha nga Prizreni, me adresë rr. "William Voker", Blloku A-1, nr.5, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensimin në bazë të përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 902.63 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses F.H. nga fshati B.-Komuna e Malishevës dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit, t'ia paguaj paditëses së lartcekur për periudhën kohore 01.12.2020 deri më 30.11.2022 (gjithsej 24 muaj), shumën e përgjithshme prej 729.53 Euro (shtatëqind e njëzetë e nëntë Euro e pesëdhjetë e tre cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 05.12.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.
- II. REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I. të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, për paditësen F.H., për periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri me datë 30.11.2020, në shumën prej 173.10 Euro (njëqind e shtatëdhjetë e tre Euro e dhjetë cent).
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 Euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja F.H.përmes së autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datën 05.12.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse klasore në shkollën SHFMU “I.Q.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësja ka paraqitur padi përmes së cilës ka kërkuar që t’i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit të saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 07.10.2024, ku ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësja lidhur me pagesën e inflacionit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive në bazë të nenit 35 pika 10 e kësaj kontrate si dhe kontrata e vitit 2021, për faktin se nuk kanë të dhëna për çka duhet të paguhet ky inflacion dhe sipas tyre nuk kanë prova konkrete nga Institucionet e Kosovës-BQK, çfarë rritje ekonomike ka pasur në Kosovë dhe se çfarë përqindje të inflacionit duhet paguar. Ka shtuar se padia është në tërësi e pa bazuar pasi kjo padi është bërë vetëm në bazë të supozimeve dhe nuk ka të bëjë asgjë me inflacion, pasi nuk ka të dhëna se ku duhet të mbështetet kjo përqindje e rritjes së inflacionit dhe kjo normë e kontratës kolektive nuk mund të zbatohet. Ka theksuar se e paditura e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi kontrata kolektive e arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur nga MASHT-i dhe kjo kontratë kolektive tanimë nuk është në fuqi, pasi palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe se i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT-i për SBASHK-un më dt. 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate për shkak të mungesës së bazës ligjore. Po ashtu ka shtuar se kjo padi ka arritur parashkrimin në bazë të nenit 352 dhe 353, par. 1 të LMD-së dhe se padia është e pasafatshme, pasi ky borxh është kërkuar që nga viti 2019-2020, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2022 dhe se kontrata kolektive e vitit 2021 ka skaduar me dt.22.11.2022, dhe padia është paraqitur pas ndërprerjes së kontratës kolektive, andaj ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar sepse nuk ekziston asnjë bazë ligjore. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja F.H. është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse klasore në SHFMU “I.Q.” në fshatin B.-Komuna e Malishevës. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditëses F.H. është shuma prej 421.00 Euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga muaji dhjetor i vitit 2020 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditëses) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 Euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 1 mujore në total të jetë 0.84 Euro, apo 0.84 Euro për muaj ($421.00 * 0.2\% * 1 = 0.84$);
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 421.84 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 Euro, apo 14.34 Euro për muaj ($421.84 * 3.4\% * 12 = 172.11$);

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 €uro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 556.57 €uro, apo 50.60 €uro për muaj ($436.18 * 3.4\% * 12 = 556.57$).

Duke qenë se mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.12.2020 deri me datë 30.11.2022 në pagën e paditëses nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 05.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditëses.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi pjesërisht të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës shprehimisht theksohet që: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 05.12.2023, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 30.11.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, kërkesa e paditëses e cila është

parashkruar rezulton të jetë në shumën prej 173.10 Euro. Më konkretisht, me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 05.12.2023, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.12.2020 e deri më 30.11.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 05.12.2023, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin dhjetor 2020, pasi parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin dhjetor 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit. Kështu, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga muaji dhjetor të vitit 2020, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 104.00 Euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 Euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil
C.nr.719/23, datë 09.11.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.